



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 1533/Prot.
12

Tiranë, më 10.12.2024

Vendim nr. 95 datë 10.12.2024

Për zgjedhjen e sekretarit shkencor, kryetarit të SSHSHA dhe kryetarit të SSHNT të Akademisë së Shkencave

Mbështetur neneve 8 e 11, pika 3 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar dhe neneve 13 - 19 të *Statutit*; sot, më datë 10.12.2024, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave për zgjedhjen e sekretarit shkencor, kryetarit të SSHNT dhe kryetarit të SSHSHA, me rend dite të miratuar prej saj me njoftimin e datës 08.11.2024, me nr. prot. 1533.

Pasi u verifikua plotësimi i kuorumit sipas parashikimit në nenin 8 pika 4 të Ligjit nr. 53/2019 sipërcituar dhe në nenin 17 pika 2 dhe nenit 19 të *Statutit*, dhe rezultoi se të pranishëm fizikisht në mbledhje janë 34 anëtarë, si dhe me votimin në distancë të 14 anëtarëve sipas nenit 16 pika 3 të *Statutit*; gjithësej 48 nga 53 anëtarë;

Pas ngritjes së komisionit të zgjedhjeve sipas nenit 16 pika 3 dhe nenit 19 të *Statutit* dhe paraqitjes së relacionit të komisionit teknik;

Pasi konstatoi se dokumentacioni i nevojshëm, sipas parashikimeve në nenin 15 të *Statutit*, nga kandidatët e regjistruar për konkurrim për funksionet e sekretarit shkencor, akad. Anila Hoda; për kryetarin e SSHNT, akad. Neki Frashëri dhe për kryetarin e SSHSHA, akad. Albert Doja dhe akad. asoc. Gëzim Hoxha, është i plotë;

Pas kryerjes së procesit të zgjedhjeve me votim të fshehtë e shpalljes së rezultatit nga komisioni i zgjedhjeve, sipas procesverbalit bashkëngjitur;

Vendosi:

1. Zgjedhjen akad. Anila Hoda, në pozicionin e sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave për pesë vitet e ardhshme, me 47 vota pro, 1 kundër dhe asnjë abstenim;

2. Zgjedhjen e akad. Neki Frashërit, në pozicionin e kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike të Akademisë së Shkencave për pesë vitet e ardhshme, me 43 vota pro, 3 kundër dhe 2 abstenim;
3. Zgjedhjen e akad. asoc. Gëzim Hoxha, në pozicionin e kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave për pesë vitet e ardhshme, me 38 vota pro, 8 vota për kandidaturën e akad. Albert Dojës, dhe 2 vota abstenim;
4. Efektet financiare për sekretarin shkencor fillojnë nga data 1 janar 2025;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

